



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 79 dt. 09.10.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe bazuar në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 09.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licensë në fushën e restaurimit, për shoqërinë e ndërtimit “G.J.Group” shpk, Korçë me drejtues teknik Ark.Genci Bregu, me licensë personale restaurimi R.P.36,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë së ndërtimit “G.J.Group” shpk, me drejtues ligjor Z. Jorgaq Bardhi, për pajisje me licensë në fushën e restaurimit për *Kategorinë C*, “Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi, për shoqërinë e ndërtimit “G.J.Group” shpk, për *Kategorinë C*, “Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me drejtues teknik Ark.Genci Bregu.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI